



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe nenin 37.2 nën paragrafi (c dhe f) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 28.03.2019, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **ZNJ. SHQIPE TARA-SOKOLI** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Rahovec nga subjekti politik "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës-AAK" duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj. Bjondina Kleqka.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj. Shqipe Tara-Sokoli dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 10.09.2018, nr.613/2018, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit znj. Bjondina Kleqka, pas dorëheqjes së saj të parevokueshme nga pozita e anëtares të Kuvendit të Komunës për arsye personale.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatës të radhës sipas listës së rirenditur, e cila është, znj. Shqipe Tara-Sokoli nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 28.03.2019

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka